

Në bazë të nenit 158-b paragrafi (1) pika 4 dhe nenit 158-g pika (1) e në lidhje me nenin 94 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 88/05, 79/07, 08/08, 88/08, 56/09, 67/10, 44/11, 88/13, 43/14, 12/14, 153/15, 192/15, 23/16, 83/2018 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/19 dhe 31/20), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në seancën e mbajtur më 28.4.2022 solli rregulloren në vijim:

Rregullore për sigurimin e jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese kur i siguruari e merr përsipër rrezikun investues

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen bazat për ushtrimin e punëve të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese kur i siguruari e merr përsipër rrezikun investues në lidhje me ndryshimin e vlerës së kuponëve investues ose letrave të tjera me vlerë të fondeve investuese në pajtim me nenin 5 paragrafi (1) pika 21) të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve (në tekstin e mëtutjeshëm: sigurimi i jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese).

Përkufizime

Neni 2

Nacionet e përdorura në këtë rregullore e kanë kuptimin në vijim:

- Shoqëri e sigurimit (në tekstin që vijon: shoqëri) – është shoqëria e sigurimit e cila ka marrë leje nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve për ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve në klasën e sigurimit 21 – Sigurimi i jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese kur i siguruari e merr përsipër rrezikun investues në lidhje me ndryshimin e vlerës së kuponëve investues ose letrave të tjera me vlerë të fondeve investuese;
- Fondi i hapur investues – paraqet pronë të veçantë, pa cilësi të personit juridik, ku pronarët e pjesëmarrjeve të tij kanë të drejtën e pjesës proporcionale të fitimit të fondit dhe në çdo kohë kanë të drejtë të kërkojnë pagesën e pjesëmarrjes, duke u tërhequr nga fondit;
- Shoqëria e menaxhimit me fondet investuese (në tekstin që vijon: SHMFI) – është shoqëri aksionare me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila ka marrë leje nga Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut për ushtrimin e aktiviteteve për themelimin dhe menaxhim të fondeve investuese;
- Portofoli investues – është numri i përgjithshëm i pjesëmarrjeve në fondet investuese për një kontratë sigurimi;
- Vlera e portofolit investues – është produkti nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrjeve dhe çmimi i pjesëmarrjes në ditën e përlogaritjes;
- Vlera neto për pjesëmarrje është vlera neto e pronës së fondit e pjesëtuar me numrin e pjesëmarrjeve të fondit në momentin e përlogaritjes së vlerës neto të pronës së fondit;
- Pjesëmarrje në fondin investues – është pjesë përlogaritëse proporcionale e vlerës së përgjithshme të fondit investues;

- Çmimi i pjesëmarrjeve në fondin e hapur është çmimi i vetëm i vlerës neto të pronës së fondit për pjesëmarrje, që përlllogaritet në bazë të çmimit të tregut të të gjithë letrave me vlerë nga portofoli i fondit; dhe
- Vlera neto e pronës së fondit investues – është vlera e pronës e zvogëluar për shumën e detyrimeve të fondit.

Struktura e primit të sigurimit

Neni 3

Primi i sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese të cilën e paguan kontraktuesi i sigurimit gjatë lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese përbëhet nga:

- Primi i sigurimit – pjesë e primit e dedikuar për mbulimin e sigurimit në rast të vdekjes dhe/ose mbijetesës së të siguarit, me ç’rast shoqëria formon provigjon matematik;
- Primi i investimit – pjesë e primit të dedikuar për blerje të pjesëmarrjeve në fondin investues të regjistruar në Regjistrin e Fondeve Investuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e të cilin e mban Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilën shoqëria e sigurimit të jetës formon rezervë të veçantë; dhe
- Shpenzime për realizim të sigurimit – pjesë e primit i cili ka të bëjë me mbulimin e shpenzimeve për blerje të policës, shpenzimeve administrative, kompensimet hyrëse dhe dalëse të fondit investues, nëse SHMFI-ja në pajtim me prospektin e fondit i paguan të njëjtat dhe shpenzime të tjera lidhur me realizimin e sigurimit.

Investimi dhe evidenca

Neni 4

(1) Shoqëria është e detyruar që fondet e primit për investim për të cilat ndahet rezervë e veçantë t’i investojë në pjesëmarrje të fondeve të hapura investuese të cilat janë regjistruar në Regjistrin e Fondeve Investuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilin e mban Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Shoqëria është e detyruar që të mbajë regjistër të veçantë në të cilin do t’i evidentojë pjesëmarrjet në fonde të hapura investuese me të cilat disponon, e që janë fituar me primin për investim, për çdo kontraktues/të siguar veçmas.

(3) Në regjistrin e pjesëmarrjeve nga paragrafi (2) i këtij neni për çdo të siguar veçmas regjistrohen së paku të dhënat në vijim:

- numri i policave;
- informacioni për të siguarin: emri dhe mbiemri, datëlindja dhe vendbanimi;
- Informacioni për kontraktues të sigurimit:
 - Për person juridik: firma, selia dhe numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), dhe
 - Për person fizik: emri dhe mbiemri, datëlindja dhe vendbanimi;
- Numri i pjesëmarrjeve, çmimi i pjesëmarrjeve në ditën e blerjes, vlera e përgjithshme e portofolit investues në ditën e blerjes së pjesëmarrjeve;
- Emërtimi i plotë i fondit të hapur investues ku janë investuar fondet,

- numri identifikues i fondit të hapur investues;
- informacioni për çdo ndryshim të gjendjes së pjesëmarrjeve, të plotësuar me datë dhe kohë të ndryshimit; dhe
- gjendja aktuale e pjesëmarrësve me: numër të pjesëmarrjeve, çmimi i pjesëmarrjeve, vlera e përgjithshme e portofolit investues.

(4) Ndryshimet në regjistrin nga paragrafi (2) i këtij neni duhet të dokumentohen me:

- Vërtetim për blerje/shitje të pjesëmarrjes të lëshuar nga SHMFI-ja pas arkëtimit/pagesës së kryer;
- Dokument të brendshëm të shoqërisë nëse shfrytëzohet portofoli investues për arkëtim të primit të sigurimit ose mbulim të shpenzimeve të tjera në pajtim me kushtet e dakorduara; ose
- Dokument për marrje/tjetërsim të pjesëmarrjes në bazë tjetër.

(5) Shoqëria është e detyruar që të vendosë procedura të brendshme dhe sisteme të sigurisë për futje, përditësim dhe ruajtje të të dhënave në regjistrin nga paragrafi (2) i këtij neni.

Elementet e detyrueshme të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për sigurim gjatë lidhjes së kontratave të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese

Neni 5

Shoqëria është e detyruar që në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit:

- 1) Të parashikojë dispozita në rast se ndodh bashkimi ose likuidimi i fondit të hapur investues ku investohet primi për investim, me të cilat kontraktuesit/të siguruarit do t'i jepet alternativë:
 - të kalojë në fond tjetër të SHMFI-ja e njëjtë ose
 - të kalojë në fond tjetër të një SHMFI tjetër,

për të cilën kontraktuesi/i siguruari duhet të prononcohet në afat prej 15 ditësh. Të gjithë shpenzimet lidhur me pranimin e alternativës i merr përsipër shoqëria.
- 2) të parashihen dispozita nëse kontraktuesi/i siguruari nuk e pranon mundësinë për të kaluar në fond tjetër në pajtim me pikën (1) të këtij neni, me të cilat shoqëria do të konsiderojë se ka ndodhur rast i mbijetesës ose kontraktuesit/të siguruarit do t'i paguhet vlerë e portofolit investues pa arkëtim të çfarëdo shpenzimeve dalëse dhe do t'ia kthejë pjesën e pashfrytëzuar të primit për sigurim; dhe
- 3) të parashohë dispozita me të cilat do ta kufizojë kohën ndërmjet arkëtimit të primit për investim dhe blerje të pjesëmarrjeve në fondet e hapura investuese më së shumti në pesëmbëdhjetë ditë pune.

Arkëtimi i primit nga portofoli investues

Neni 6

(1) Nëse me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit ose me kontratë të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese është parashikuar që primi i sigurimit të arkëtohet nga portofoli investues, në ditën në të cilën është paraparë arkëtimi i primit të sigurimit të portofolit investues shoqëria kryen blerje të numrit të përshtatshëm të pjesëmarrjeve të portofolit investues të kontraktuesit të sigurimit, kështu që produkti i numrit të pjesëmarrjeve të tërhequra me çmimin e pjesëmarrjes nga fondi i hapur investues në ditën e tërheqjes përkon me shumën e primit të sigurimit.

(2) Shoqëria është e detyruar që në kuadër të njoftimit të rregullt vjetor, ta njoftojë të siguarin për shumën e pjesëmarrjeve të tërhequra, çmimin (e blerjes) të pjesëmarrjes nga fondi i hapur investues dhe shpenzimet e lidhura me këtë transaksion për çdo tërheqje nga portofoli investues në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Informacion për vlerën e pjesëmarrjeve të fondeve të hapura investuese

Neni 7

Shoqëria është e detyruar që të sigurojë të dhëna ditore për vlerën e pjesëmarrjeve të fondeve të hapura investuese të cilat janë pjesë përbërëse e produktit të sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese të cilat do t'i publikojë në faqen e saj të internetit ose do të ofrojë link në burimet zyrtare të të dhënave që kanë obligim të njoftojnë (faqja e internetit e SHMFI-së ose Komisionit për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut).

Dokument me informacione kryesore

Neni 8

(1) Shoqëria, përfaqësuesi në sigurim ose brokeri i sigurimit, janë të detyruar që kontraktuesit e sigurimit, para lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese, t'i dorëzojë ose dërgojë (me dërgesë postare të rekomanduar ose përmes postës elektronike) dhe dokument me informacione kryesore lidhur me produktin e sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese, me ç'rast shoqëria e sigurimit është e detyruar që të sigurojë vërtetim për pranim nga ana e kontraktuesit të sigurimit.

(2) Dokumenti me informacione kryesore nga paragrafi (1) të këtij neni përpilohet si dokument i shkurtër prej së paku tre faqesh, me madhësi A4 kur shtypet. Nëse shfrytëzohen ngjyra në dokumentin me informacione kryesore, ato nuk guxojnë ta reduktojnë të kuptuarin e informacioneve nëse dokumenti me informacione kryesore është shtypur ose kopjuar me ngjyrë të zezë dhe të bardhë.

(3) Dokumenti me informacione kryesore nga paragrafi (1) i këtij neni duhet t'i përmbushë kushtet në vijim:

- të paraqitet dhe strukturohet në mënyrë që të jetë i thjeshtë për t'u lexuar dhe me madhësi të shkronjave që mundësojnë lexim;
- të jetë i fokusuar në informacione kryesore që i nevojiten kontraktuesit/të siguarit; dhe
- të jetë i shkruar në gjuhë e cila është e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme dhe që mundëson kuptim të lehtë të informacioneve.

(4) Dokumenti me informacione kryesore nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet informacion parakontraktues dhe i njëjti duhet të jetë i saktë, i vërtetë, i qartë dhe i harmonizuar në aspektin terminologjik dhe esencial me të gjitha dokumentet kontraktuese obliguese (p.sh. ofertë për sigurim, kushte për sigurim).

(5) Dokumenti me informacione kryesore nga paragrafi (1) i këtij neni është dokument i pavarur, i veçuar qartë nga materiali promovues i shoqërisë.

Struktura dhe përmbajtja e dokumentit me informacione kryesore

Neni 9

(1) Dokumenti me informacione kryesore nga neni 8 i kësaj rregullore doemos duhet të jetë i shkruar në gjuhën zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Titulli “Dokumentit me informacione kryesore” doemos duhet të paraqitet në vend të dukshëm në faqen e parë të Dokumentit me informacione kryesore.

(3) Menjëherë nën titullin e Dokumentit me informacione kryesore gjendet arsyetim në të cilin është theksuar: “Ky dokument përmban informacione kryesore për produktin e sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese kur i siguruari e merr përsipër rrezikun investues dhe ka për qëllim t’ju ndihmojë në të kuptuarit e natyrës, rreziqeve, shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve potenciale nga ky produkt dhe t’ju ndihmojë ta krahasoni me produktet e tjera. Ky dokument nuk paraqet material promovues (reklamues)”.

(4) Dokumenti me informacione kryesore nga neni 8 i kësaj rregulloreje i përmban elementet në vijim:

1. Të dhëna të përgjithshme;
2. Cilat janë karakteristikat kryesore të produktit?;
3. Cilat janë rreziqet dhe pritjet nga produkti?;
4. Cilat janë pasojat në rastet kur shoqëria nuk mund të bëjë pagesë?;
5. Cilat dhe sa janë shpenzimet lidhur me produktin?;
6. Opsionet për ndërprerje të parakohshme të kontratës dhe pasojat;
7. Informacione për parashtrim të kundërshtimeve dhe parashtrësive; dhe
8. Informacione të tjera relevante.

(5) Forma dhe përmbajtja e Dokumentit me informacione kryesore nga neni 8 i kësaj rregulloreje është dhënë në Ankesin 1 të kësaj rregullore dhe është pjesë përbërëse e saj, ndërsa detajet dhe mënyra e plotësimit janë dhënë në Udhëzimin për plotësimin e Dokumentit me informacione kryesore që është dhënë në Ankesin 2 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Përditësimi i Dokumentit me informacione kryesore

Neni 10

(1) Shoqëria është e detyruar që t'i përditësojë informacionet e përfshira në Dokumentin me informacione kryesore në të gjitha rastet kur ndodh ndryshim i cili ndikon dukshëm ose ka gjasa se do të ndikojë në informacionet e përfshira në Dokumentin me informacione kryesore.

(2) Edhe krahas dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria është e detyruar që ta përditësojë Dokumentin me informacione kryesore në çdo tre muaj, brenda një afati prej 10 ditësh pas përfundimit të tremujorit.

(3) Shoqëria do ta publikojë Dokumentin e përditësuar me informacione kryesore në faqen e saj të internetit me shënimin e datës në të cilën është bërë përditësimi.

Parimet themelore gjatë përpilimit të Dokumentit me informacione kryesore dhe promovim reklamues të produktit të sigurimit

Neni 11

(1) Shoqëria është përgjegjëse për plotësinë dhe saktësinë e informacioneve që do të përfshihen në Dokumentin me informacione kryesore, si dhe për informacionet që publikohen për promovimin reklamues të produktit të sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese.

(2) Gjatë miratimit të Dokumentit me informacione kryesore dhe gjatë publikimit të reklamave për produktin e sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese, shoqëria duhet t'i respektojë parimet në vijim:

- duhet të paraqitet përshkrim i plotë, i saktë dhe i vërtetë i produktit të sigurimit që prezantohet/promovohet, si dhe rreziqet shoqëruese;
- duhet doemos të publikohen të dhëna të plota dhe të qarta në mënyrë që të mos mashtrohen të siguruarit,
- duhet doemos të sigurohet që përmbajtja dhe forma e reklamave të mos shtrembërojnë, fshehin ose zvogëlojnë kuptimin e cilësdo deklaratë, paralajmërim ose fakti tjetër të përfshirë në Dokumentin me informacione kryesore si në kushtet e përgjithshme ashtu edhe në ato të veçanta të sigurimit gjatë lidhjes së kontratave të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese.

Njoftime të tjera para lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese

Neni 12

(1) Përveç dokumentit me të dhënat kryesore nga neni 8 i kësaj rregulloreje, shoqëria është e detyruar që para lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës lidhur me pjesëmarrjet në fondet investuese me kontraktuesin/të siguruarin ta njoftojë kontraktuesin/të siguruarin për shpërndarjen e primit sipas komponentëve (primi i investimit, primi i sigurimit dhe shpenzimet e zbatimit të sigurimit, shumat e tatimeve, taksat dhe shpenzimet e tjera që mund të lindin), si dhe shpenzimet dalëse në rast të blerjes së sigurimit.

(2) Nëse ekziston kusht i caktuar për ndonjë nga variablat që e përbëjnë primin e sigurimit, në njoftimin nga paragrafi (1) i këtij neni, nevojitet të jepet sqarim me të gjitha elementet e njohura para lidhjes së kontratës.

Dorëzimi në kohë
Neni 13

(1) Shoqëria, përfaqësuesi në sigurim ose brokeri i sigurimit i cili e shet produktin e sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese do të mundësojë që kontraktuesi/i siguruari potencial i sigurimit t'i marrë në kohë Dokumentin me informacione kryesore dhe informacione të tjera para lidhjes së kontratës së sigurimit.

(2) Dispozita nga neni (1) ka të bëjë edhe me ato situata kur në kontratën e sigurimit është paraparë periudha e dorëheqjes pas lidhjes së kontratës.

Njoftimi i rregullt vjetor i të siguarit

Neni 14

(1) Shoqëria është e detyruar që i siguruari të dorëzojë raport vjetor për kontratën e lidhur të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese brenda një afati prej 30 ditësh nga mbarimi i vitit afarist.

(2) Raporti vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni i përfshin së paku të dhënat në vijim:

- 1) të gjitha arkëtimet në bazë të primit të sigurimit dhe shpërndarjes së premit: premin e sigurimit, premin e investimit dhe shpenzimet e realizimit të sigurimit;
- 2) shuma e portofolit investues në fillim të vitit afarist (përfshirë edhe numrin e pjesëmarrjeve dhe çmimin e pjesëmarrjes), përkatësisht nga fillimi i kontratës së sigurimit nëse është e lidhur gjatë vitit afarist;
- 3) ndryshimet që kanë ndodhur në vitin afarist, veçmas për çdo ndryshim në portofolin investues (numri i pjesëmarrjeve, çmimi i pjesëmarrjes dhe data e ndryshimit dhe përshkrimi i transaksionit (p.sh. arkëtimi, pagesa për shkak të mbulimit të shpenzimeve, pagesa për shkak të pagesës së primit etj); dhe
- 4) shuma e portofolit investues në fund të vitit (përfshirë edhe numrin e pjesëmarrjeve dhe çmimin e pjesëmarrjes).

Obligime për njoftim të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Neni 15

(1) Shoqëria është e detyruar që ta dorëzojë Dokumentin me informacione kryesore për çdo produkt të sigurimit në kuadër të sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimit, brenda shtatë ditëve para fillimit të zbatimit të tij.

(2) Dokumentin me informacione kryesore nga paragrafi (1) i këtij neni shoqëria e sigurimit është e detyruar që ta dorëzojë në Agjenci në afatin e parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni në formë elektronike në mënyrën e përcaktuar nga ana e Agjencisë së Mbikëqyrës së Sigurimeve.

**Dispozita përfundimtare
Neni 16**

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 tetori i vitit 2022.

Nr. 01-344/1

28.4.2022

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve

Kërste Shajnoski

ПРИЛОГ 1: ФОРМА И СОДРЖИНА НА ДОКУМЕНТ СО КЛУЧНИ ИНФОРМАЦИИ/АНЕКСИ 1: FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT ME INFORMACIONE KRYESORE

ДОКУМЕНТ СО КЛУЧНИ ИНФОРМАЦИИ/ДОКУМЕНТ МЕ ИНФОРМАЦИОНЕ КRYESORE
<p>НАМЕНА/DEDIKIM:</p> <p>Овој документ содржи клучни информации за осигурителен производ за осигурување на живот во врска со удели во инвестициски фондови кога осигуреникот го презема инвестициониот ризик и има за цел да ви помогне во разбирање на природата, ризиците, трошоците, можните добивки и загуби од овој производ и да ви помогне да го споредите со други производи. Овој документ не претставува промотивен (рекламен) материјал/Ky dokument përmban informacione kryesore për produktin e sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjet në fondet investuese kur i siguruari e merr përsipër rrezikun investues dhe ka për qëllim t’ju ndihmojë në kuptimin e natyrës, rreziqeve, shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve potenciale nga ky produkt dhe t’ju ndihmojë ta krahasoni me produkte të tjera. Ky dokument nuk paraqet material (reklamues) promovues.</p>
<p>I. ОПШТИ ПОДАТОЦИ/ТË DHËNA ТË PËRGJITHSHME</p>
<p>II. КОИ СЕ КЛУЧНИТЕ КАРАКТЕРИСТИКИ НА ОВОЈ ОСИГУРИТЕЛЕН ПРОИЗВОД/СИЛАТ ЈАНË КАРАКТЕРИСТИКАТ КRYESORE ТË КËТИЈ ПРОДУКТИ ТË СИГУРИМИТ?</p> <p><i>Опис на осигурувањето/Përshkrimi i sigurimit</i></p> <p><i>Цели и начин на остварување на тие цели/ Qëllimet dhe mënyra e realizimit të atyre qëllimeve</i></p> <p><i>Таргет група/ Grupi i synuar</i></p> <p><i>Користи и трошоци од осигурителниот производ/Dobi dhe shpenzime nga produkti i sigurimit</i></p>
<p>III. КОИ СЕ РИЗИЦИТЕ И ОЧЕКУВАЊАТА ОД ПРОИЗВОДОТ/СИЛАТ ЈАНË RREZIQET DHE PRITJET NGA ПРОДУКТИ?</p> <p><i>Показател на ризик/Tregues i rrezikut</i></p> <p><i>Приноси на отворениот инвестициски фонд/Të ardhurat e fondit të hapur investues</i></p>
<p>IV. КОИ СЕ ПОСЛЕДИЦИТЕ ВО СЛУЧАЈ ДРУШТВОТО ДА НЕ МОЖЕ ДА ИЗВРШИ ИСПЛАТА/СИЛАТ ЈАНË PASOJAT NË RAST SE SHOQËRIA NUK MUND ТË KRYEJË PAGESË?</p>
<p>V. КОИ И КОЛКАВИ СЕ ТРОШОЦИТЕ ПОВРЗАНИ СО ПРОИЗВОДОТ/СИЛАТ ДHE SA ЈАНË SHPENZIMET LIDHUR ME ПРОДУКТИН?</p> <p><i>Трошоци низ текот на времето/Shpenzimet gjatë kohës</i></p> <p><i>Расчленување на трошоците/Ndarja e shpenzimeve</i></p>
<p>VI. ОПЦИИ ЗА ПРЕДВРЕМЕНО ПРЕКИНУВАЊЕ НА ДОГОВОРОТ И ПОСЛЕДИЦИ/OPSIONE PËR NDËRPRERJE ТË PARAKONSHME ТË KONTRATËS DHE PASOJAT</p>
<p>VII. ИНФОРМАЦИИ ЗА ПОДНЕСУВАЊЕ НА ПРЕТСТАВКИ/ПРИГОВОРИ/INFORMACIONET PËR PARAQITJEN E PARASHTRESAVE/ANKESAVE</p>
<p>VIII. ОСТАНАТИ РЕЛЕВАНТНИ ИНФОРМАЦИИ/INFORMACIONE ТË TJERA RELEVANTE</p>

ANEKSI 2: UDHËZIMI PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTIT ME INFORMACIONE KRYESORE

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Kjo pjesë e Dokumentit me informacione kryesore ka të bëjë me identitetin e shoqërisë së sigurimit të jetës e cila e ofron produktin e sigurimit (ku i siguruari e merr përsipër rrezikun investues) dhe organi kompetent i mbikëqyrjes dhe i njëjti duhet t'i përmbajë informacionet në vijim:

1. emërtimi i produktit të sigurimit lidhur me fondin e hapur investues (Emërtimi i shkurtër i fondit të hapur investues dhe Numri identifikues i fondit të hapur investues);
2. emërtimi i shoqërisë së sigurimit të jetës i cili e ofron produktin e sigurimit, faqja e internetit në të cilin investuesi do të mund të marrë informacion si të hyjë në kontakt me shoqërinë e sigurimit të jetës dhe numri i telefonit për kontakt;
3. të dhënat për organin kompetent të mbikëqyrjes, përkatësisht të dhënat për Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimit (emërtimi i plotë, adresa, faqja e internetit dhe telefoni për kontakt);
4. data e përgatitjes së Dokumentit me informacione kryesore, përkatësisht në rast të përditësimit, data e përditësimit të fundit të Dokumentit me informacione kryesore.

II. PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE KRYESORE TË PRODUKTIT

1. Kjo pjesë e Dokumentit me informacione kryesore ka të bëjë me formën juridike të produktit të sigurimit.

2. Informacionet në lidhje me qëllimet e produktit të sigurimit dhe mënyrën se si do të realizohen ato qëllime duhet të përmbledhen në këtë pjesë të shkurtër, të qartë dhe të kuptueshme. Informacionet duhet t'i identifikojnë faktorët kryesorë nga të cilët varen të ardhurat, instrumentet financiare themelore në të cilat investohen fondet, si përcaktohen të ardhurat dhe cila është lidhja ndërmjet të ardhurave të produktit të sigurimit dhe instrumenteve financiare themelore në të cilat investohen fondet. Informacioni duhet ta pasqyrojë lidhjen ndërmjet periudhës së rekomanduar për ruajtje dhe profilit të rrezikut të produktit të sigurimit.

3. Nëse lista e instrumenteve financiare të përmendura në pikën 2 është aq e vëllimshme sa që nuk mund të përfshihet në Dokumentin me informacione kryesore, nevojitet që të theksohen segmentet e tregut ose llojet e instrumenteve lidhur me instrumentet financiare themelore.

4. Në përshkrimin e grupit të synuar të investitorëve për të cilin është dedikuar ky produkt sigurimi, është e nevojshme të sigurohen informacione për investitorin e synuar të identifikuar nga shoqëria, veçanërisht në lidhje me nevojat, karakteristikat dhe qëllimet e llojit të klientit me të cilët ky produkt i sigurimit është kompaktibil. Këto supozime bazohen në mundësinë që investitori ta përballojë humbjen e investimit në kuadër të horizontit të tij të preferuar të investimit, njohurive të tij teorike dhe përvojës së kaluar me tregjet financiare, dhe në veçanti me investimin në fondet e hapura investuese, si dhe nevojat, karakteristikat dhe qëllimet e klientit të mundshëm përfundimtar.

5. Në përshkrimin e detajuar të përfitimeve të sigurimit, nevojitet që të sigurohet rezyme e përgjithshme, përkatësisht karakteristikat kryesore të kontratës së sigurimit, përkufizimi për të gjitha përfitimet me sqarim se vlera e këtyre përfitimeve është paraqitur në pjesën "Cilat janë rreziqet dhe çfarë mund të fitoj si kthim?". Në rastet kur primi paguhet si shumë e njëhershme, në shumën e

detajuar futet shuma e investuar. Nëse primi paguhet periodikisht, në informacionin ceket numri i pagesave periodike dhe vlerësimi i shumës së investuar mesatare.

6. Përshkrimi i detajuar i cekur në pikën 5, gjithashtu jep sqarim për efektin e primeve të paguara të sigurimit, si ekuivalent i vlerës së caktuar të përfitimeve nga sigurimi, mbi kthimin e investimit të investuesit.

7. Informacionet për afatin e fundit të mbulimit të produktit të sigurimit në pjesën nën titullin “Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produktit” në Dokumentin me informacione kryesore nevojitet të përfshihen të gjitha informacionet në vijim:

1. data e afatit të fundit të mbulimit të produktit të sigurimit ose shënimi se nuk ekziston datë e afatit të fundit të mbulimit;
2. indikacioni nëse shoqëria ka të drejtë ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme produktin e sigurimit;
3. përshkrimi i rrethanave në të cilat produkti i sigurimit mund të ndërpritet automatikisht dhe data e ndërprerjes, nëse është e njohur.

III. PËRSHKRIMI I RREZIQEVE DHE PRITJET NGA PRODUKTI

1. Në këtë pjesë të Dokumentit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet ta zbatojë metodologjinë për prezantim të rrezikut dhe përlllogaritje të shkallës mesatare të të ardhurave për pjesëmarrje të fondit të hapur investues të paraparë me *Vendimin për përcaktimin e mënyrës së përlllogaritjes së të ardhurave për pjesëmarrje në fondin e hapur investues dhe për përlllogaritjen e paqëndrueshmërisë së fondit investues të miratuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

2. Shoqëria nevojitet që ta publikojë treguesin e rrezikut sintetik dhe të ardhurave, përkatësisht klasën e rrezikshme të fondit të hapur investues të shkallës së përcaktuar nga 1 deri në 7, me potencim të treguesit të përcaktuar në formatin në vijim:

1	2	3	4	5	6	7
< ----- >			>			
Понижок ризик/ Rrezik më i uët			Повисок ризик/ Rrezik më i lartë			

3. Krahas treguesit nga pika 2, shoqëria nevojitet të japë:

1. sqarim për valutën në të cilën produkti i sigurimit është denominuar, nëse kjo është valutë ndryshe nga denari dhe se mund të ndodhin ndryshime si rezultat i fluktuacioneve të kurseve devizore;
2. përshkrim të shkurtër të rrezikut të produktit të sigurimit dhe pritjet për të ardhura dhe privilegje, duke potencuar se efekti i rrezikut të produktit i sigurimit mund të jetë shumë më i lartë nëse nuk është ruajtur deri në maturimin, përkatësisht deri në periudhën e rekomanduar për ruajtje, atje ku ekziston mundësia.
3. Tregues për humbjen e mundshme maksimale, si dhe informacion se investimi mund të humbet nëse nuk mbrohet pjesërisht ose plotësisht me fondin garantues nëse shoqëria nuk është në gjendje ta paguajë.

4. Shoqëria do të paraqesë të dhëna për të ardhurat mesatare të fondit të hapur investues në përqindje me 4 pozita decimale, në formatin në vijim:

Просечен месечен принос за <назив на отворениот инвестициски фонд>/Тë ardhurat mujore mesatare <emërtimi i fondit të hapur investues>			
	Последни 12 месеци/12 muajt e fundit	Последни 24 месеци/24 muajt e fundit	Последни 5 години/5 vitet e fundit
Просечен месечен принос/Тë ardhurat mujore mesatare	%	%	%

5. Shoqëria është e detyruar që të sigurojë informacion me lidhje në faqen e internetit ku është publikuar prospekti ose forma e shkurtër e prospektit të fondit të hapur investues.

IV. CILAT JANË PASOJAT NË RAST NËSE SHOQËRIA NUK MUND TË BËJË PAGESË?

Në këtë pjesë të Dokumentit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet të zbulojë:

1. nëse investuesi mund të ballafaqohet me humbje financiare për shkak të moskryerjes së obligimeve nga shoqëria ose moskryerja e obligimeve nga SHMFI-ja, dhe për shkak të identitetit të atij ose atyre subjekteve;
2. sqarim nëse humbja e cekur në pikën (1) është mbuluar me garanci të caktuar për investuesin ose skemën e sigurimit për kompensim dhe nëse ka kufizime ose kushte për atë mbulim.

V. CILAT DHE SA JANË SHPENZIMET LIDHUR ME PRODUKTIN?

1. Në këtë pjesë të Fushëveprimit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet që t'i zbulojë të gjitha shpenzimet që janë të lidhura me produktin e sigurimit, me atë që do t'i zbulojë të gjitha informacionet:

1. të gjitha shpenzimet e njëhershme, siç janë shpenzimet hyrëse dhe dalëse, të shprehura si përqindje nga parametri përkatës (primi, vlera e fondit investues, shuma e siguruar etj);
2. të gjithë shpenzimet periodike dhe të përsëritshme, siç janë shpenzimet vjetore për transaksione me portofol dhe shpenzimet tjera periodike dhe të përsëritshme, të shprehura si përqindje nga parametri përkatës (primi, vlera e fondit investues, shuma e siguruar etj.);
3. shpenzimet e kohëpaskohshme dhe të paparashikueshme, siç janë kompensimet për sukses ose pjesëmarrje në leverdinë, të shprehura si përqindje nga parametri përkatës (primi, vlera e fondit investues, shuma e siguruar etj).

Primi i përgjithshëm (primi i njëhershëm ose kësti nga primi shumëfishtë) i zvogëluar për të gjitha shpenzimet nga ky paragraf, është e barabartë me primin për investim për primin e sigurimit për periudhën përkatëse.

2. Informacionet për shpenzime të njehershme i përbëjnë elementet në vijim:

1. shpenzim i njehershëm është shpenzim hyrës dhe dalës që përfshin kompensime fillestare, komisione dhe të gjitha shumat e tjera të paguara drejtpërdrejt nga investuesi, shumat që hiqen nga pagesa e parë ose nga numri i kufizuar i pagesave të primit që duhet t'i pranojë investuesi ose nga pagesa pas blerjes ose ndërprerjes së produktit të sigurimit;
2. shpenzimet e njehershme i përfshijnë të gjitha llojet e shpenzimeve lidhur me produktin e sigurimit, pa dallim nëse ato paraqesin shpenzime të lidhura drejtpërdrejt, ose kompensim për punën e kryer për çfarëdo entitet lidhur me shoqërinë ose i cili shoqërisë i ofron shërbime;
3. shpenzimet e njehershme i përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në llojet vijuese të shpenzimeve hyrëse dhe kompensimeve që do të merren parasysht në shumën që duhet të zbulohet për produktin e sigurimit;
4. shpenzime për strukturim ose marketing;
5. shpenzime për blerje, shpërndarje dhe shitje;
6. shpenzime për hartimin dhe punën, përfshirë edhe shpenzime për menaxhim me investimet dhe portofolin investues.

3. Informacionet për shpenzimet përsëritëse i përbëjnë elementet në vijim:

- 1) Shpenzimet përsëritëse janë pagesa që hiqen rregullisht nga dy ose më shumë arkëtimeve të investitorit ose nga shuma e investuar ose nga shumat që nuk janë shpërndarë, sipas mekanizmit të përcaktuar për shpërndarje të fitimit;
- 2) Shpenzimet përsëritëse i përfshijnë të gjitha llojet e shpenzimeve lidhur me produktin e sigurimit, pa dallim nëse ato paraqesin shpenzime që kanë ndodhur drejtpërdrejt te shoqëria, ose janë në formë të kompensimit për punën e kryer për cilindo entitet lidhur me shoqërinë ose shoqërisë i ofron shërbime;
- 3) Shpenzimet përsëritëse i përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në llojet vijuese të shpenzimeve hyrëse dhe kompensimeve të cilat do të merren parasysht në shumën që duhet të zbulohet për produktin e sigurimit;
- 4) Shpenzimet për strukturim ose marketing;
- 5) Shpenzimet për blerje, shpërndarje dhe shitje;
- 6) Shpenzimet për hartimin dhe punën, përfshirë edhe shpenzimet për menaxhim me investimet dhe portofolin investues;
- 7) Shpenzime të tjera administrative;
- 8) Cilado shumë me të cilën në mënyrë implicite e ngarkon shumën e investuar, siç janë bërë shpenzimet për menaxhim me investimet e shoqërisë (p.sh. shpenzimet për investimet e reja, etj.); dhe
- 9) Pagesa palëve të tretë për shlyerjen e shpenzimeve që janë bërë lidhur me marrjen dhe shitjen e cilitdo mjet (përfshirë shpenzime transaksionale).

4. Shoqëria nevojitet që të përshkruajë secilën prej shpenzimeve të ndarë në tabelën "Ndarja e shpenzimeve", duke cekur në cilat rrethana dhe në cilën mënyrë ato shpenzime mund të dallohen nga shpenzimet reale të cilat investuesi mund t'i përballojë, përkatësisht në cilat rrethana dhe në cilën mënyrë këto shpenzime mund të varen nga vendimi i investuesit për të realizuar ose mosrealizuar mundësi të caktuara.

Расчленување на трошоците/Ndarja e shpenzimeve			
Еднократни трошоци/Shpenzime të njëhershme	Влезни трошоци/Shpenzime hyrëse	%	Ефект на трошоците што ги плаќате при склучување договор за осигурување. Ова е најголемата сума што ќе ја платите, а може и да платите помалку. Тоа исто така ги вклучува трошоците за дистрибуција на вашиот производ/Efekti i shpenzimeve që i paguani gjatë lidhjes së kontratës së sigurimit. Kjo është shuma më e madhe që do ta paguani, por mund të paguani edhe më pak. Kjo gjithashtu i përfshin shpenzimet për shpërndarje të produktit tuaj.
	Излезни трошоци/Shpenzime dalëse	%	Ефект на трошоците што ги плаќате при престанок на осигурувањето после крајниот рок на покритие/Efekti i shpenzimeve që i paguani gjatë ndërprerjes së sigurimit pas afatit të fundit të mbulimit.
Повторувачки трошоци/Shpenzime përsëritëse	Трансакциски трошоци на инвестициското портфолио/Shpenzime transaksionale të portofolit investues	%	Ефект на трошоците за купување и продажба на уделите во отворените инвестициски фондови/Efekti i shpenzimeve për blerje dhe shitje të pjesëmarrjeve në fondet e hapura investuese.
	Останати повторувачки трошоци/Shpenzime tjera përsëritëse	%	Ефект на трошоците што се наплатуваат секоја година за управување со вашите инвестиции и други трошоци. Ова ги вклучува давачките за управување и другите административни трошоци./Efekti i shpenzimeve që arkëtohen çdo vit për menaxhim me investimet tuaja dhe shpenzimet tjera. Kjo i përfshin shpenzimet për menaxhim dhe shpenzimet tjera administrative.
Повремени и непредвидени трошоци/Shpenzime të parakohshme të papaparara	Надоместоци за успешност/Kompensime për sukses	%	Ефект на трошоците што се наплатуваат доколку приносот ја надмине референтната вредност./Efekti i shpenzimeve që arkëtohen nëse të ardhurat e tejkalojnë vlerën referente.
	Учество во добивка/Pjesëmarrja në fitim	%	Ефект на трошоците што се наплатуваат доколку вложувањето ја надмине референтната вредност./Efekti i shpenzimeve që arkëtohen nëse investimi e tejkalon vlerën referente.
Напомена/Vërejtje: <се наведува во кои околности и на кој начин тие трошоци можат да се разликуваат од реалните трошоци што инвеститорот може да ги сноси>/potencohet se në cilat rrethana dhe në cilën mënyrë ato shpenzime mund të dallohen nga shpenzimet reale të cilat mund t'i përballojë investuesi.			

VI. PËR NDËRPRERJE TË PARAKOSHME TË KONTRATËS DHE PASOJAT

1. Në këtë pjesë të Dokumentit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet që të japë:

1. përshkrim të shkurtër i arsyeve për zgjedhjen e periudhës së rekomanduar ose të nevojshme kontraktuale minimale për ruajtjen e produktit të sigurimit;
2. përshkrim të karakteristikave të procedurës së dezinvestimit dhe kur është i mundur dezinvestimi, duke përfshirë tregues të pasojave të ndërprerjes së produktit të sigurimit në profilin e rreziqeve dhe suksesit të produktit të sigurimit, ose mbi zbatueshmërinë e garancive kapitale;
3. informacion për çfarëdo kompensimi ose dënimi të cilat mund të ndodhin për shkak të dezinvestimit para maturimit ose ndonjë datë tjetër të caktuar, përveç periudhës së rekomanduar kontraktuale të produktit të sigurimit, duke përfshirë referim në informacionet për shpenzimet të cilat duhet të përfshihen në Dokumentin me informacione kryesore në pajtim me pikën V të këtij udhëzimi dhe sqarim të ndikimit të kompensimeve dhe dënimeve të tilla për periudhat e ndryshme të mbajtjes së produktit të sigurimit.

VII. INFORMACIONE PËR PARAQITJEN E PARASHTRESAVE DHE ANKESAVE

Në këtë pjesë të Dokumentit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet që t'i sigurojë informacionet në vijim:

1. hapat që duhen ndjekur për qëllimet e paraqitjes së parashtresës/ankesës për produktin e sigurimit ose për sjelljen e shoqërisë ose për personin që këshillon ose shet produktin e sigurimit;
2. link për faqen përkatëse të internetit për paraqitjen e parashtresës/ankesës;
3. adresa e përditësuar postare dhe adresa elektronike në të cilën mund të paraqiten parashtresa/ankesa; dhe
4. procedura e paraqitjes së parashtresave/ankesave para Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve

VIII. INFORMACIONE TË TJERA RELEVANTE

1. Në këtë pjesë të Dokumentit me informacione kryesore, shoqëria nevojitet që t'i citojë të gjitha dokumentet e disponueshme me informacione plotësuese, si dhe informacionin nëse dokumentet me informacione plotësuese janë të disponueshme në bazë të detyrimit juridik ose vetëm me kërkesë të investuesit.

2. Informacionet e përfshira në pjesën me titull "Informacione të tjera relevante" të Dokumentit me informacione kryesore mund të jepen në formën përmbledhëse, përfshirë edhe linkun për faqen e internetit ku janë të aksesueshme detaje plotësuese, përveç dokumenteve të cituara në pikën 1.